

Në përputhje me nenin 6 paragrafi 2 të ligjit “Për kontrollin e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësisë strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës” (“Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës”, numër: 103/09) Ministri i Sigurisë miraton:

RREGULLOREN

PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PËRPUNIMIT TË KËRKESAVE PËR DHËNIEN E DOKUMENTEVE PËR TRANSITIN E MALLRAVE TË PËRCAKTUARA NË LISTAT E KONTROLLIT

I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. (Objekti i Rregullores)

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra dhe procedura e përpunimit të kërkesave për dhënie e dokumenteve për transitin e mallrave të specifikuar në Vendimin për marrjen e listës së armëve dhe pajisjeve ushtarake për lëvizjen e së cilave nevojitet miratim (“Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës”, numër: 94/09 dhe 82/10), përmbajtja e kërkesës dhe organi kompetent për dhënie e dokumenteve për transit.

II. DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR DHËNIEN E DOKUMENTEVE PËR TRANSITIN E MALLRAVE TË PËRCAKTUARA NË LISTAT E KONTROLLIT PËRMES TERRITORIT TË BOSNJË-HERCEGOVINËS (TRANSITI)

Neni 2. (Depozitimi i kërkesës)

Kërkesa për dhënie e dokumenteve për transitin e mallrave të përcaktuara në Vendimin për marrjen e listës së armëve dhe pajisjeve ushtarake për lëvizjen e të cilave nevojitet miratim (në vijim: listat e kontrollit) depozitohet në Ministrinë e Sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës (në vijim: Ministria) në rastin e lëvizjes së mallrave përmes territorit të Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 3. (Përjashtimet nga zbatimi)

- (1) Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk zbatohen për transitin e mallrave të cilat nuk janë të përcaktuara në Vendimin për marrjen e listës së armëve dhe pajisjeve ushtarake për lëvizjen e të cilave nevojitet miratim (“Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës”, numër: 94/09 dhe 82/10).
- (2) Për mallrat të cilat nuk janë përcaktuar në Vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni janë kompetent: Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës Sërbska të Bosnjë-Hercegovinës, ministrinë kantonale të punëve të brendshme dhe Policia e Distriktit të Bërçkos e Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 4. (Përmbajtja e kërkesës)

- (1) Kërkesa nga neni 2 i kësaj Rregulloreje depozitohet sipas formularit, përmbajtja dhe forma e të cilit përcaktohet në dokumentin numër 1 bashkëlidhur kësaj Rregulloreje dhe që është pjesë përbërëse e saj.
- (2) Formulari nga paragrafi 1 i këtij neni përmban të dhënat e mëposhtme:

- 1) emrin dhe adresën e depozituesit të kërkesës;
- 2) emrin dhe adresën e dërguesit;
- 3) emrin dhe adresën e marrësit;
- 4) specifikimet e armëve (emrin, prodhuesin, sasinë, numrin e serisë dhe mënyrën e paketimit);
- 5) mënyrën e transportit (rrugor, hekurudhor, ajror, detar);
- 6) të dhënat rreth mjetit të transportit (tipi dhe marka e mjetit të transportit, targat);
- 7) emrin dhe mbiemrin e drejtuesit të automjetit, numrin personal të identifikimit, numrin e kartës së identitetit ose të pasaportës, (në rastin e transportit rrugor);
- 8) pikën e nisjes (data dhe koha e planifikuar e nisjes);
- 9) emrin e pikës kufitare të hyrjes dhe kohën e planifikuar të mbërritjes;
- 10) emrin e pikës kufitare të daljes dhe kohën e planifikuar të mbërritjes;
- 11) itinerarin e lëvizjes;
- 12) destinacionin final.

Neni 5. **(Dokumentacioni i nevojshëm)**

- (1) Bashkë me kërkesën e plotësuar, depozituesi i kërkesës dorëzon dhe lejen për import ose eksport të ministrisë kompetente, kontratën për dërgimin ose urdhrin e blerjes dhe vërtetimin e pagesës së tarifës administrative.
- (2) Kërkesa për dhënien e dokumenteve për transitin e mallrave depozitohet 60 ditë përpara kryerjes së aktivitetit.
- (3) Nëse janë disa palë të përfshira në tregtinë e jashtme është e nevojshme të depozitohet dokumentacioni i cili tregon rrjedhën e operacioneve të tregtisë së jashtme. Për ndërmjetësit në transit nevojitet të depozitohen dokumentet e vendit të origjinës së ndërmjetësit të cilat tregojnë se ndërmjetësi është regjistruar në mënyrë të rregullt dhe se aktiviteti i tij rezulton i regjistruar.
- (4) Të gjitha dokumentet të cilat dorëzohen me kërkesën duhet të jenë në një nga gjuhët zyrtare në Bosnjë-Hercegovinë. Nëse dokumenti është në një gjuhë të huaj, me origjinalin depozitohet dhe përkthimi i përkthyesit të licencuar për përkthimin e gjuhës së përdorur në dokument.
- (5) Në rast se gjatë depozitimit të kërkesës mungon ndonjë nga dokumentet apo të dhënat nga paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 i këtij neni, ministria do të caktojë afatin brenda të cilit depozituesi i kërkesës duhet të plotësojë kërkesën.

Neni 6. **(Masat e veçanta të sigurisë)**

Në raste të veçanta, në vendimin me të cilin miratohet transiti, ministria mund të urdhërojë masa të veçanta gjatë lëvizjes së mallrave nëpër territorin e Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 7. **(Dhënia e vendimit)**

Nëse gjatë procedurës rezulton se janë përmbushur kushtet për dhënien e dokumentit për transit nëpër territorin e Bosnjë-Hercegovinës, ministria do të marrë vendimin përkatës të veçantë.

Neni 8.
(Njoftimi për vendimin e dhënë)

- (1) Pas miratimit të vendimit nga neni 5 i kësaj Rregulloreje, Ministria e Sigurisë ia dërgon këtë vendim depozituesit të kërkesës.
- (2) Pas vendimit të miratuar nga paragrafi 1 i këtij neni, ministria informon ministritë e punëve të brendshme të entiteteve dhe Policinë e Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës duke referuar numrin e lejes për transit.
- (3) Ministritë kompetente të punëve të brendshme të entiteteve dhe Policia e Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës janë të detyruara që pas marrjes së njoftimit nga paragrafi 2 i këtij neni të kryejnë informimin e organeve policore mbi transitin e mallrave të cilat ndodhen përgjatë itinerarit të transimit të mallrave.

Neni 9.
(Refuzimi i kërkesës)

Në rast se gjatë procedurës rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për transitin e mallrave nëpër territorin e Bosnjë-Hercegovinës merret vendimi për refuzimin e kërkesës.

Neni 10.
(Verifikimi nga Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnjë-Hercegovinës)

- (1) Në raste të veçanta, ministria, para dhënies së vendimit, mund të kërkojë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnjë-Hercegovinës që nëpërmjet kanaleve diplomatike të kryejë verifikimin e statusit të subjektit juridik, depozituesit të kërkesës, dërguesit dhe marrësit të mallrave.
- (2) Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnjë-Hercegovinës është e detyruar që të nisë menjëherë procedurën me qëllim sigurimin e informacionit të kërkuar nga paragrafi 1 i këtij neni dhe t'ia përcjellë këtë informacion ministrisë.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 11.
(Formulari)

Formulari numër 1 i bashkëlidhet kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 12.
(Hyrja në fuqi)

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në “Fletoren Zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës”.

Numër: _____/10
Sarajevë: _____2010

MINISTRI

DOKUMENTI 1- FORMULARI I KËRKESËS

Depozituesi i kërkesës/ emri i subjektit juridik ose personit fizik, selia dhe adresa, numri dhe data/
Organi kompetent të cilit i dërgohet kërkesa/ selia dhe adresa/

KËRKESË

Për dhënien e dokumentit për transitin e mallrave nëpër territorin e Bosnjë-Hercegovinës për armët dhe pajisjet ushtarake

1.	Emri dhe adresa e depozituesit të kërkesës: Personi i kontaktit dhe nr. i telefonit:					
2.	Emri dhe adresa e dërguesit: Personi i kontaktit dhe nr. i telefonit:					
3.	Emri dhe adresa e marrësit: Personi i kontaktit dhe nr. i telefonit:					
4.	Specifikimi i armëve:	emri	prodhuesi	sasia	numri i serisë	mënyra e paketimit
		1. 2. ...etj.				
5.	Mënyra e transportit: (rrugor, hekurudhor, ajror, detar)					
6.	Të dhënat e mjetit të transportit (lloji dhe marka e mjetit të transportit, targa)					
7.	Emri dhe mbiemri i drejtuesit të automjetit: Nr. personal i identifikimit: Numri i kartës së identitetit ose pasaportës: (në rast transporti rrugor)					
8.	Pika e nisjes: Data dhe koha e planifikuar e fillimit të transportit:					
9.	Emri i pikës kufitare të hyrjes dhe koha e planifikuar e mbërritjes. (në rastin e transitit)					
10.	Emri i pikës kufitare të daljes (në rastin e transitit)					
11.	Drejtimi i lëvizjes:					
12.	Destinacioni final:					

Ju lutem bashkëlidhni kërkesës (dokumenti i bashkëlidhur duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar):

- Lejen për import ose eksport të lëshuar nga ministria kompetente (në rastin e transitit)
- Kontratën për dërgimin ose urdhrin e blerjes
- Vërtetimin e pagesës së tarifës administrative

VULA

.....
emri, mbiemri dhe firma e personit të autorizuar